



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 tetor 2023  
Nr.ref.: RK 2287/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI120/22**

Parashtrues

**Gëzim Shtufi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës  
[Pml. nr. 270/22] të 13 korrikut 2022**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gëzim Shtufi më vendbanim në Komunën e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Valbona Morina dhe Isa Salihu, avokatë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 270/22] të 13 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), lidhur me nenin 6 (E Drejta në Proces të Rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme për të pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim efektiv, të shqiptuar me Aktgjykimin [PAKR. nr. 179/221] të Gjykatës së Apelit dhe të vërtetuar me Aktgjykimin e kontestuar [PML. nr. 270/2022] të Gjykatës Supreme të 13 korrikut 2022.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafin 2 të nenit 116 [Efektet Juridike të Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 (Masat e përkohshme) dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023 u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018 do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 4 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 8 gusht 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI120/22] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI120/22], caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban, anëtarë.
9. Më 11 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar të plotësuar në mbështetje të kërkesës së tij.

10. Më 15 gusht 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 6 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi në Gjykatë një dokument shtesë në mbështetje të kërkesës se tij.
12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 30 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Parashtruesi i kërkesës paraqet kërkesë për herë të dytë në Gjykatë, respektivisht kërkesën KI196/21 dhe kërkesën aktuale, ku Gjykata do t'i paraqesë faktet e dy kërkesave ndaras si në vijim.

### ***Faktet e rastit lidhur me kërkesën e parë KI196/21***

15. Më 20 shkurt 2015, Prokuroria Themelore në Prizren ngriti aktakuzën PP. nr. 3063/2013 kundër parashtruesit të kërkesës dhe dy personave të tjerë S. D. dhe Z. Th., të gjithë nga Komuna e Prizrenit, për veprën penale të “kanosjes” nga neni 185, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
16. Më 19 qershor 2015, Gjykata Themelore në Prizren, nëpërmjet Aktgjykimit [P. nr. 333/15], refuzoi aktakuzën e ngritur kundër parashtruesit dhe të akuzuarve, sepse prokurorja e çështjes para përfundimit të gjykimit të çështjes ishte tërhequr nga aktakuza, për shkak se në seancën e shqyrtimit kryesor i dëmtuari L. Sh. hoqi dorë nga ndjekja e mëtejme penale kundër të akuzuarve, duke deklaruar se me të njëjtit “kam arritur gjuhën e pajtimit dhe të mirëkuptimit”.
17. Më 9 dhjetor 2016, Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për krime të rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore), ngriti aktakuzën [PP. nr. 274.2015] kundër K. D., për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale “fajdes” nga neni 343, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, K. B., për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale të “fajdes në ndihmë” nga neni 343, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 33 të KPRK-së, dhe parashtruesit të kërkesës këtë radhë për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale të “detyrimit” nga neni 340, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe veprës penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së. Që të gjithë të akuzuarit janë nga Komuna e Prizrenit.
18. Më 21 shtator 2017, Gjykata Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 224/16, i), e liroi parashtruesin e kërkesës nga aktakuza për veprën penale të “detyrimit” nga neni 340, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, ndërsa ii) e shpalli atë fajtor për veprën penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së, duke e dënuar me gjobë në shumën prej 2500 euro (dy mijë e pesëqind euro). Në lidhje me veprën penale të “detyrimit”, gjykata në fjalë konstatoi se parashtruesi i kërkesës me Aktgjykimin [P. nr. 333/15] të 19 qershorit 2015, për këtë veprë penale, ishte liruar më parë nga të gjitha pikat e aktakuzës dhe se bazuar në neni 34 të Kushtetutës “askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën veprë”.

19. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, ankesë parashtruan edhe parashtruesi i kërkesës edhe Prokuroria Themelore. Parashtruesi i kërkesës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal. Ndërsa, Prokuroria Themelore për pjesën liruese të Aktgjykimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në lidhje me sanksionin penal.
20. Më 26 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit PAKR. nr. 541/2017, e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shpalljen e tij fajtor për veprën penale të *“mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve”*, duke e vërtetuar në këtë pjesë Aktgjykimin [P. nr. 224/16] e Gjykatës Themelore, ndërsa sa i përket lirimit nga aktakuza për veprën penale të *“detyrimit”*, e anuloi Aktgjykimin [P. nr. 224/16] e Gjykatës Themelore, duke e kthyer të njëjtin në rigjykim në prani të kësaj të fundit, me arsyetimin se: *“është i gabueshëm konstatimi i Gjykatës (Gjykatës Themelore) se i akuzuari Gëzim Shtufi është gjykuar një herë për çështjen e njëjtë penale, nëse i referohemi Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 333/15, të dt.19.02.2015 dhe bëjmë analizimin dhe krahasimin në këtë çështje penale, koha e kryerjes së veprës penale nuk është e njëjtë, shuma e borxhit apo huas së marrë nuk është e njëjtë, dhe përfitimi joproporcional nuk është përmendur, andaj nuk kemi të bëjmë me një çështje të gjykuar edhe pse i dëmtuari dhe i akuzuari janë të njëjtë”*. Kryesuese e Kolegjit shqyrtues në këtë vendimmarrje ishte gjyqtarja M.M).

*Kthimi i rastit në rigjykim (hera e parë)*

21. Më 18 prill 2018, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 2/2018, refuzoi sërish aktakuzën e ngritur kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale të *“detyrimit”*, me arsyetimin se kjo çështje ishte gjykuar njëherë dhe se e njëjta ishte bërë *res judicata* me Aktgjykimin [P. nr. 333/15] të 19 qershorit 2015 dhe se i njëjti person nuk mund të gjykohej sërish për të njëjtën veprë penale.
22. Ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur parashtrroi Prokuroria Themelore *“... për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe të njëjtën ta kthej në rigjykim ose ta ndryshoj, në atë mënyrë që të akuzuarin K.D., K.B., Gëzim Shtufi dhe A.D., t'i shpallë fajtorë duke iu shqiptuar dënimet e parapara me ligj”*.
23. Më 9 tetor 2018, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit PAKR. nr. 443/2018, anuloi Aktgjykimin [P. nr. 2/2018] e Gjykatës Themelore, të 18 prillit 2018, duke e kthyer sërish çështjen në rivendosje në Gjykatën Themelore, përkitazi me refuzimin e aktakuzës ndaj parashtruesit të kërkesës, në lidhje me veprën penale të *“detyrimit”*. Nëpërmjet këtij aktvendimi, Gjykata Themelore u urdhërua që çështja të gjykohej nga një trup tjetër gjykues. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, theksoi se *“Meqenëse trupi gjykues i cili ka gjykuar në shkallë të parë nuk i është përmbajtur vërejtjeve dhe udhëzimeve të Gjykatës së Apelit e të cilat konform dispozitave ligjore janë të obliguara, ky kolegji vendosi që në rigjykim kjo çështje penalo-juridike t'i jepet një trupi tjetër gjykues”*. Kryesuese e Kolegjit shqyrtues në këtë vendimmarrje ishte sërish gjyqtarja M. M).

*Kthimi i rastit në rigjykim (hera e dytë)*

24. Më 21 mars 2019, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit PKR. nr. 86/2018, e refuzoi sërish aktakuzën e ngritur ndaj parashtruesit të kërkesës për veprën penale të *“detyrimit”*, me arsyetimin se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar *res judicata*, sepse për këtë veprë penale ekziston një aktgjykim i plotfuqishëm, prandaj kjo rrethanë

përbën pengesë për gjykim të serishëm të kësaj çështje penale, bazuar në parimin *ne bis in idem*.

25. Prokuroria Themelore, kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtrori sërish ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
26. Më 8 janar 2020, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit PAKR. nr. 327/2019, e anuloi Aktgjykimin [PKR. nr. 86/2018] e Gjykatës Themelore të 21 marsit 2019, duke e kthyer sërish çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore, duke urdhëruar këtë të fundit që kjo çështje penale sërish të gjykohej nga një trup gjykues tjetër. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit, theksoi se: *"... sa i përket çështjes se a bëhet fjalë për çështje të gjykuar apo jo, nuk qëndron vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë, se bëhet fjalë për rast të njëjtë, për të cilin është vendosur me vendim të formës së prerë të Gjykatës Themelore -..., ngase, gjithëherë sipas shkresave të lëndës rasti i mëparshëm ka përfunduar në qershor të vitit 2015, ndërsa i dëmtuari pas përfundimit të këtij rasti ka shkuar në polici dhe e ka lajmëruar rastin se i akuzuari edhe më tutje është duke e kërcënuar dhe duke i kërkuar para të dëmtuarit, ku përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë ka dhënë deklaratë të detajuar dhe gjithmonë ka konstatuar se flitet për rastin pas qershorit 2015"*.

#### *Kthimi i rastit në rigjykim (hera e tretë)*

27. Më 12 janar 2021, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit PKR. nr. 3/2020, e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe tre të akuzuarit tjerë për shkak të kryerjes së veprës penale të detyrimit nga neni 267.2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke ia shqiptuar të njëjtit dënimin me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Në arsyetimin e saj, Gjykata Themelore theksoi se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, pasi që sipas aktakuzës objekti i shqyrtimit nuk ishte identik me objektin e shqyrtimit në Aktgjykimin P. nr. 333/15 e 19 qershorit 2015, në të cilin thirrret parashtruesi i kërkesës.
28. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, Prokuroria Themelore parashtrori ankesë në Gjykatën e Apelit, për sa i përket vendimit për sanksionin penal, sipas nenit 387, paragrafëve 1 dhe 2 të KPRK-së, duke propozuar që: *"Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin ashtu që të akuzuarit K. D, për shkak të veprës penale Kontraktim i përfitimit jo proporcional, nga neni 270 të KPRK-së, t'i shqiptoj dënim me burg ose dënim me të lartë me gjobë, të akuzuarit K. B, për shkak të veprës penale Kontraktim i përfitimit joproporcional në ndihmë nga neni 270, lidhur me nenin 25 të KPRK-së, t'i shqiptoj dënim me burg ose dënim me të lartë me gjobë, të akuzuarit Gëzim Shtufi (parashtruesi i kërkesës), për shkak të veprës penale Detyrim nga neni 267, par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK -së, t'i shqiptoj dënim me burg efektiv dhe të akuzuarit A. D, për shkak të veprës penale Detyrim nga neni 340, par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, t'i shqiptoj dënim me burg ose dënim me gjobë më të lartë"*.
29. Më 7 maj 2021, Prokuroria e Apelit, nëpërmjet parashtrësës [PPA/Lnr. 185/21], propozoi që ankesa e Prokurorisë Themelore të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarve K. D., K. B. dhe A. D. t'u shqiptohen dënime me burg ose dënime më të larta me gjobë, ndërsa të akuzuarit Gëzim Shtufi t'i shqiptohet dënim me burg efektiv.

30. Parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet mbrojtjes së tij, në Gjykatën e Apelit parashtrroi përgjigje në ankesë kundër propozimit të Prokurorisë Themelore për ashpërsim të masës së dënimit, duke kërkuar që një propozim i tillë të refuzohet si i pabazuar.
31. Më 14 qershor 2021, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore dhe përgjigjes në ankesë të parashtruesit të kërkesës, nëpërmjet Aktgjykimit [PAKR. nr. 179/2021], e ndryshoi Aktgjykimin [PKR. nr. 3/2020] e Gjykatës Themelore të 12 janarit 2021, vetëm sa i përket vendimit për dënimin, duke e rritur dënimin me burgim me kusht nga 1 (një) vit në dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit arsyetoi se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye se nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, edhe pse bëhet fjalë për palë të njëjta në procedurë, veprimi kryesor i të akuzuarit ndryshon, sepse në lëndën e cila është kryer me aktgjykim refuzues, i akuzuari (parashtruesi) është ngarkuar për veprën penale të “kanosjes”, ndërsa në rastin konkret i njëjti akuzohet për veprën penale të “detyrimit”.
32. Më 12 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 179/2021] të 14 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 3/2020] të 12 janarit 2021 të Gjykatës Themelore, me pretendimin se të njëjtit janë marrë me shkelje të nenit 432, paragrafit 1, nënparagrafit 1.2, në lidhje me nenin 384, paragrafin 1, pikën 1.7 dhe pikën 1.8, në lidhje me nenin 370, paragrafin 1, pikat 6.7 dhe 8, si dhe nenin 361 të KPPRK-së, duke arsyetuar se këto shkelje kanë tërhequr edhe shkeljen e nenit 403 të KPPRK-së. Parashtruesi i kërkesës nëpërmjet këtij mjeti juridik kërkoi gjithashtu shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim efektiv derisa Gjykata Supreme të nxjerrë vendim meritore për çështjen.
33. Më 14 shtator 2021, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet Aktgjykimit [PML. nr. 310/2021], e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtuar kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 179/2021] të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 3/2020] e Gjykatës Themelore në Prizren të 12 janarit 2021, duke konfirmuar kështu aktgjykimet e instancave më të ulëta si të drejta dhe të bazuara në ligj, si për nga zbatimi i ligjit penal ashtu edhe për nga zbatimi i dispozitave esenciale të ligjit procedural. Në këtë vendimmarrje, pjesë e Kolegjit shqyrtues ishte gjyqtarja M. M., si dhe gjyqtarët V.D., dhe A.M.
34. Më 26 maj 2022, Gjykata Kushtetuese, duke vendosur për kërkesën KI196/21, erdhi në përfundim dhe konstatoi se Aktgjykimi [PML. nr. 310/2021] i Gjykatës Supreme i 14 shtatorit 2021 është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse (i) është nxjerrë nga përbërja e një Kolegji, në të cilin në kundërshtim me dispozitat përkatëse të procedurës penale dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, kishte marrë pjesë gjyqtarja M.M., e cila gjithashtu ishte pjesë e vendimmarrjes në fazat e mëhershme të çështjes së njëjtë penale, përkatësisht dy herë në cilësinë e kryesueses së kolegjeve në Gjykatën e Apelit, kur është vendosur për akuzën penale të parashtruesit të kërkesës, dhe së fundmi edhe si anëtare e Kolegjit, kur është vendosur për kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme; dhe në rrethana të tilla, (ii) dyshimet legjitime për mungesën e paanësisë së gjykatës janë objektivist të justifikueshme.
35. Gjykata rikujton se nëpërmjet Aktgjykimit KI196/21, ajo ka shpallur të pavlefshëm vetëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021] e 14 shtatorit 2021, të nxjerrë si rezultat i ushtrimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 179/2021] të 14 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin [PKR. nr.

3/2020], e 12 janarit 2021 të Gjykatës Themelore në Prizren. Në pikën IV të pjesës operative, Gjykata vendosi *“TË KTHEREJË Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021] e 14 shtatorit 2021 të Gjykatës Supreme për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate”*.

### **Faktet e rastit në lidhje me kërkesën e tanishme KI120/22**

36. Më 13 korrik 2022, Gjykata Supreme, duke vendosur sipas urdhrin të Gjykatës Kushtetuese, rishqyrtoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe nxori Aktgjykimin [Pml. nr. 270/2022], përmes të cilit e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 3/2020] të Gjykatës Themelore të 12 janarit 2021 dhe Aktgjykimit [PAKR. NR. 179/2021] të 14 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit.
37. Në këtë vendimmarrje, pjesë e Kolegjit shqyrtues ishin serish gjyqtarët V.D., dhe A.M., si dhe gjyqtarja N.S.
38. Gjykata Supreme në trajtim të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës fillimisht theksoj se *“Gjykata Supreme e Kosovës, pasi eliminoi shkeljen e theksuar në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, serish rishqyrtoi pretendimet e paraqitura në kërkesë [...]”*.
39. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata Supreme vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara, meqë: *“aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyetim të hollësishëm dhe në mënyrë të plotë janë theksuar provat vendimtare që kanë vërtetuar fajësinë e të dënuarve .... dëshmitarët janë dëgjuar në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit gjyqësor .... dhe të dënuarit dhe mbrojtësit e tyre kanë pasur mundësi në parashtrimin e pyetjeve dhe marrjen e sqarimeve të drejtpërdrejta nga ana e dëshmitarëve, andaj aplikimi i kësaj dispozite është tërësisht i panevojshëm. Në këtë kontekst është e rëndësishme të potencohet fakti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk bazohet vetëm mbi dëshmitë e dëshmitarëve, por edhe provave materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor [...]”*.
40. Gjykata Supreme, përmes të njëjtit Aktgjykim, tutje theksoi se: *“në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të qartë janë përshkruar të gjitha veprimet e të dënuarve e veçanërisht vendi, koha dhe mënyra e veprimit të tyre, dhe për më tepër, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar faktin se në veprimet e të dënuarve janë manifestuar të gjitha tiparet e përcaktuara të veprave penale për të cilat të dënuarit janë shpallur fajtor”*.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si rezultat i cenimit të (i) paanshmërisë së gjykatës dhe (ii) të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

#### **i. Pretendimet lidhur me “paanshmërinë e gjykatës”**

42. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës pretendon se në gjykimin e rastit të tij penal ka marrë pjesë tri herë gjyqtarja M. M., dhe atë në dy nivele të ndryshme gjyqësore; së pari si kryesuese e kolegjit në Gjykatën Apelit në Aktgjykimin [PAKR. nr. 541/2017] e 26 dhjetorit 2017; së dyti po ashtu si kryesuese e kolegjit në Aktgjykimin

[PAKR. nr. 443/2018] e 9 tetorit 2018; dhe së treti si anëtare e kolegjit në Gjykatën Supreme në Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021]e 14 shtatorit 2021, veprime që sipas parashtruesit të kërkesës e bëjnë “Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të mos jetë në përputhshmëri me kërkesat e të “drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”.

43. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNj-së dhe të Gjykatës, në veçanti rasteve të bashkuara KI187/18 dhe KI11/19, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, si dhe dispozitave relevante të KPPRK-së që e rregullojnë çështjen e përjashtimit të gjyqtarëve në procedurat e rregullta.
44. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës tutje argumenton se “një prej garancioneve themelore që ofron neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së, është gjykimin nga një gjykatë e paanshme. Ky garancion procedural sanksionohet qartë edhe në nenin 39 të KPP-së”.
45. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson se “Jurisprudenca e GJEDNj-së, të cilën e ka zbatuar me përpikëri edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vë në dukje në mënyrë të qartë se marrja pjesë e të njëjtit gjyqtar në vendimmarrje gjyqësore në dy shkallë të ndryshme, gjatë vendosjes për meritat e rastit, paraqet cenim të parimit të paanshmërisë së gjykatës (“paanshmëria funksionale”). Ky cenim bëhet edhe më i rëndë në raste penale, kur parashtruesit e kërkesave shpallen fajtorë dhe dënohen me burgim. Një situatë e tillë paraqitet në këtë rast prandaj - për më tepër kur në këtë rast e njëjta gjyqtare ka marrë pjesë në 3 vendimmarrje gjyqësore të rastit penal të parashtruesit të kërkesës dhe atë dy herë në Gjykatën e Apelit, si kryesuese e kolegjit dhe një herë në Gjykatën Supreme. Prandaj, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. 310/2021, i datës 14.09.2021, paraqet shkelje flagrante të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 39 të KPP-së”.
46. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me Aktgjykimin e kontestuar specifikisht pretendon “Kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe sigurisë, mos përcaktueshmërisë së veprës penale neni 2 paragraf 2 dhe neni 3 i KPRK-së në raport me parashtruesin e kërkesës ku me aktgjykimin të kundërligjshëm të nxjerrë nga gjykatat e rregullta duke mos e përfillur procedurën e përcaktuar me ligj përkatësisht nenin 12 paragraf 1 lidhur me nenin 307 paragraf 2 të Kodit Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr 38/ 28 dhjetor 2012, Prishtinë (tutje i referohemi me KPP)”.
47. Parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [Pml. nr. 270/22] i Gjykatës Supreme i 13 korrikut 2022, “jo vetëm që nuk i eviton aspak shkeljet duke vazhduar me të njëjtin avaz të shkeljeve kushtetuese e cila merrë po të njëjtin vendim me të njëjtin kolegji shqyrtues, dhe e shpërfill në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sikur ai të mos ekzistoj fare, as kolegjin nuk e ndryshon, edhe pse kjo e fundit e kishte obliguar Gjykatën Supreme, që kjo çështje të rivendoset nga një kolegji i ri shqyrtues”.
48. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se “Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me aktgjykimin e cekur si me lartë me kryeneçësi nuk ndryshon as kolegjin shqyrtues edhe asnjë pike të aktgjykimit të mëparshëm, duke i ripërsëritur të njëjtat shkelje si me parë, duke mos ia var veshin Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, edhe pse kjo gjykatë kishte konstatuar shkelje nga Gjykata Supreme”.
49. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se Kolegji i ri i Gjykatës Supreme që nxori Aktgjykimin e kontestuar në procedurën e rigjyimit do duhej të ishte tërësisht i ndryshëm nga Kolegji paraprak i Gjykatës Supreme që kishte nxjerrë



Aktgjykimin [PML. nr. 310/21] të 14 shtatorit 2021, në mënyrë që të plotësohen kërkesat për paanshmëri në rigjykimin e rastit të tij.

50. Parashtruesi i kërkesës në substancë pretendon mungesë të paanshmërisë specifikuish në procedurën e rigjykimit të rastit të tij, pasi gjyqtarët V.D., dhe A.M., të cilët ishin pjesë e Kolegjit të ri të Gjykatës Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit të dytë dhe të kontestuar, ishin të njëjtit gjyqtarë që morën pjesë në Aktgjykimin e parë, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 310/21] e 14 shtatorit 2021.
51. Parashtruesi i kërkesës rrjedhimisht pohon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimi të kontestuar ka dështuar të jap arsyetim dhe njëkohësisht ka shprehur arbitraritet në vendimmarrja.
52. Parashtruesi i kërkesës ndër të tjera shton se *“Iusim titullin e lartpërmendur, përkitazi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që të angazhohet fuqishëm në zbatimin e përpikte për Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me numrin e Rastit nr. KI196/21 të datës 13 qershor 2022 me Nr.ref, AGJ 2007/22, në rastin e Gëzim Shtufi”*.
53. Parashtruesi i kërkesës përfundimisht kërkon nga Gjykata që (i) të shpallë kërkesën e pranueshme; të aprovojë kërkesën për masë të përkohshme si dhe të pezullojë ekzekutimin e Aktgjykimit [PAKR. nr. 179/2021] të 14 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit; (ii) të konstatojë se Aktgjykimi [Pml. nr. 270/2022] i 13 korrikut 2022 i Gjykatës Supreme nuk është në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, duke e shpallur të njëjtin të pavlefshëm dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

#### **Neni 6**

## (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

## Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

### Neni 39

#### Bazat për përjashtimin e gjyqtarëve

[...]

3. "Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i Kolegjit të Apelit apo Kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues".

[...]

#### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

54. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
55. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

56. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashikohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashikojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

1. "Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49  
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]".

57. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML. nr. 270/2022] të 13 korrikut 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
58. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 34 (2) specifikisht përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".

59. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26, dhe [KI175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

60. Gjykata fillimisht rikujton që me Aktgjykimin [P. nr. 333/15] të 19 qershorit 2015 të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës ishte liruar nga akuza për kryerjen e veprës penale të “*kanosjes*” sipas nenit 185, paragrafit 1 të KPRK-së. Prokuroria Themelore, kundër parashtruesit të kërkesës për herë të dytë kishte ngritur aktakuzën PP. nr. 3063/2013 për kryerjen e veprës penale të “*detyrimit*” nga neni 340.2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe për veprën penale të “*mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve*” nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së. Gjykata Themelore, me Aktgjykimin P. nr. 224/16, e kishte liruar parashtruesin nga akuza sa i përket veprës penale të “*detyrimit*” dhe e kishte shpallur fajtor atë për veprën penale të “*mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve*” dhe e kishte dënuar me gjobë në shumën prej 2500 euro. Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas ankesës së Prokurorisë Themelore, me Aktvendimin PAKR. nr. 541/2017, e kthen çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore, e cila nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 2/2018, e refuzon sërish aktakuzën ndaj parashtruesit të kërkesës për veprën penale të “*detyrimit*”, duke u thirrur në parimin *res judicata*. Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas ankesës së Prokurorisë Themelore, me Aktvendimin PAKR. nr. 443/2018, për herë të dytë e rikthen çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore, e cila nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 86/2018, e refuzon sërish aktakuzën ndaj parashtruesit, duke u thirrur në parimin *res judicata* dhe *ne bis in idem*.
61. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u kontestua sërish nga Prokuroria Themelore në Gjykatën e Apelit, e cila me Aktvendimin PAKR. nr. 327/2019, e rikthen për herë të tretë çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore, dhe kjo e fundit me Aktgjykimin PAKR. nr. 3/2020, e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe e dënoi atë me burgim me kusht, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ankesë kishte parashtruar Prokuroria Themelore, por vetëm sa i përket lartësisë së dënimit të shqiptuar, me ç’rast Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit PAKR. nr. 179/2021, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e rritur dënimin nga 1 (një) vit të dënimit me kusht në 3 (tri) vite me burgim efektiv. Parashtruesi i kërkesës kundër këtij Aktgjykimi kishte ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila me Aktgjykimin e kontestuar PML. nr. 310/2021, e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe i vërtetoi aktgjykimet e instancave më të ulëta, duke e lënë në fuqi dënimin e shqiptuar me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve ndaj parashtruesit të kërkesës. Kundër Aktgjykimit [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021 të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Kushtetues me arsyetimin se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të KEDNJ-së, për shkak të cenimit të (i) së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor dhe (ii) paanshmërisë së gjykatës me pretendimin/argumentin qendrorë se në gjykimin e rastit të tij penal, kishte marrë pjesë tri herë gjyqtarja M. M., dhe atë në dy nivele të ndryshme gjyqësore.
62. Gjykata, përmes Aktgjykimit KI196/21, e shpalli të pavlefshëm vetëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021] e 14 shtatorit 2021, me arsyetimin se është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse (i) është nxjerrë nga përbërja e një Kolegji, në të cilin në kundërshtim me dispozitat përkatëse të procedurës penale dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, gjyqtarja M. M. kishte marrë pjesë 3 (tre) herë në vendimmarrje të këtij rasti penal dhe atë 2 (dy) herë në nivele të ndryshme gjyqësore. Ajo fillimisht, në cilësinë e kryesueses së Kolegjit të Gjykatës së Apelit, ishte pjesë e vendimmarrjes në Aktvendimin [PKRK. nr. 541/2017] e 26 dhjetorit 2017 dhe Aktvendimin [PKRK. nr. 443/2018] e 9 tetorit 2018, dhe në cilësinë e anëtares së Kolegjit shqyrtues mori pjesë në marrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 310/21] të Gjykatës

Supreme të 14 shtatorit 2021, të kontestuar nga parashtruesi në rastin KI196/21, dhe rrjedhimisht vendosi ta kthej; Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021] e 14 shtatorit 2021 të Gjykatës Supreme për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin KI196/21.

63. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, me arsyetimin se Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të kontestuar [Pml. nr. 270/22] të 13 korrikut 2022, nuk ka vendosur në pajtim me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese sipas Aktgjykimit KI196/21, të 26 majit 2022, lidhur me paanshmërinë e gjykatës me arsyetimin se Gjykata Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit të dytë, respektivisht Aktgjykimit [Pml. nr. 270/22] të kontestuar *“merrë po të njëjtin vendim me të njëjtin koleg shqyrtues, dhe e shpërfill në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sikur ai të mos ekzistoj fare, as kolegjin nuk e ndryshon, edhe pse kjo e fundit e kishte obliguar Gjykatën Supreme, që kjo çështje të rivendoset nga një koleg i ri shqyrtues”*. Për me tepër, parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar ka dështuar të jap arsyetim dhe njëkohësisht ka shprehur arbitraritet në vendimmarrja.
64. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon mungesë të paanshmërisë në procedurën e rigjyimit të rastit të tij, pasi gjyqtarët V.D., dhe A.M., të cilët ishin pjesë e Kolegjit të ri të Gjykatës Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar, ishin të njëjtit gjyqtarë që morën pjesë në Aktgjykimin e parë, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 310/21] të 14 shtatorit 2021.
65. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, pretendimet për moszbatim të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së dhe mosarsyetim të vendimit gjyqësor, për shkak të natyrës së rastit dhe ndërlikohjes së tyre, do t'i trajtojë në kuadër të një arsytimi të vetëm.
66. Në dritën e këtyre sqarimeve, Gjykata do të shqyrtojë në vazhdim pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.
67. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*
68. Përveç kësaj, Gjykata i rikujton gjithashtu përmbajtjen e nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, i cili përcakton:
- “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ...”*
69. Gjykata rithekson se në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-

së. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së, lidhur me çështjen e (i) paanshmërisë së gjykatës dhe (ii) së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

### **Pretendimi për shkelje të së drejtës për gjykatë të paanshme**

#### *a) Parimet e përgjithshme*

70. Në trajtimin e pretendimit të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me të drejtën në “gjykim të drejtë” dhe të “paanshëm”, në procedurën e rigjyimit të rastit nga e njëjta instancë gjyqësore, Gjykata do të aplikojë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e së cilës ajo, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe praktikës së saj të konsoliduar.
71. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se paanësia e një gjykate sipas nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të përcaktohet sipas (i) testit subjektiv, rrjedhimisht në bazë të bindjes dhe sjelljes personale të një gjyqtari, duke nënkuptuar se një gjyqtar mund të ketë pasur paragjykime personale apo anshmëri në një rast të caktuar; dhe (ii) testit objektiv, rrjedhimisht konstatimit nëse vet gjykata, mes tjerash, përbërja e saj, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së [Miracle Europe KFT kundër Hungarisë, kërkesa nr. 57774/13](#), Aktgjykim i 12 prillit 2016, paragrafët 54 dhe 55; [Gautrin dhe të Tjerët kundër Francës, kërkesa nr. \(38/1997/822/1025-1028\)](#), Aktgjykim i 20 majit 1998, paragrafi 58; [San Leonard Band Club kundër Maltës, kërkesa nr. 77562/01](#), Aktgjykim i 29 korrikut 2004, paragrafi 58; [Thomann kundër Zvicrës](#), Aktgjykim i 10 qershorit 1996, paragrafi 30; [Wettstein kundër Zvicrës, kërkesa nr. 33958/96](#), Aktgjykim i 21 dhjetorit 2000, paragrafi 42; [Korzeniak kundër Polonisë, kërkesa nr. 56134/08](#), Aktgjykim i 10 janarit 2017, paragrafi 46; dhe rastin e Gjykatës [KI06/12](#), me parashtrues *Bajrush Gashi*, Aktgjykim i 9 majit 2012, paragrafi 45, si dhe rastet e bashkuara të Gjykatës [KI187/18 dhe KI11/19](#), parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 50; si dhe rastin [KI24/17](#), parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim 17 majit 2019, paragrafi 50).
72. Më specifikisht, sa i përket testit subjektiv, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së [Mežnarić kundër Kroacisë, kërkesa nr. 71615/01](#), Aktgjykim i 30 nëntorit 2005, paragrafi 30; [Padovani kundër Italisë, kërkesa nr. 13396/87](#), Aktgjykim i 26 shkurtit 1993, paragrafi 26; [Morel kundër Francës, kërkesa nr. 34130/96](#), Aktgjykim i 6 qershorit 2000, paragrafi 41; [San Leonard Band Club kundër Maltës](#), cituar më lart, paragrafi 59; [Hauschildt kundër Danimarkës](#), Aktgjykim i 24 majit 1989, paragrafi 47; [Driza kundër Shqipërisë](#), Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 75; dhe [Korzeniak kundër Polonisë](#), cituar më lart, paragrafi 47). Për sa i përket llojit të provave të nevojshme për të dëshmuar një gjë të tillë, GJEDNJ, për shembull, është përpjekur që të vërtetojë nëse një gjyqtar tregon armiqësi ose vullnet të keq për arsye personale. Megjithatë, për të vendosur nëse në një rast konkret ka bazë të mjaftueshme për të determinuar se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, pikëpamja e parashtruesit është e rëndësishme, por jo vendimtare (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së [De Cubber kundër Belgjikës](#), Aktgjykim i 26 tetorit 1984, paragrafi 25). Megjithatë, parimi në të cilin duhet të supozohet se gjykata është e liruar nga paragjykimet apo njëanshmëria personale, është i vendosur për një kohë të gjatë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (shih, rastet e GJEDNJ-së

Kyprianou kundër Qipros, cituar më lart, paragrafi 119; Micallef kundër Maltës, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 93-94; dhe Tozicka kundër Polonisë, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 33, si dhe rastet e bashkuara të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues Muhamet Idrizi, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 51, dhe rastin KI24/17, parashtrues Bedri Salihu, paragrafi 45).

73. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përderisa në disa raste mund të jetë e vështirë të gjenden faktet bazuar në të cilat mund të përmbysset prezumimi i paanësisë subjektive të një gjyqtari, kriteret dhe kërkesat për paanësinë objektive përcaktojnë një garanci shtesë për një gjykim të paanshëm (shih rastin e GJEDNJ-së Micallef kundër Maltës, cituar më lart, paragrafët 95 dhe 101). Duhet të theksohet se në shumicën e rasteve që ndërlidhen me çështje të paanshmërisë, GJEDNJ është fokusuar dhe ka gjetur shkelje në aspektin e testit objektiv (shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, Aktgjykim i 6 nëntorit 2018, paragrafi 146; dhe Korzeniak kundër Polonisë, cituar më lart, paragrafi 48, si dhe rastet e bashkuara të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues Muhamet Idrizi, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 52; si dhe KI24/17, cituar me lart paragrafi 46)
74. Për sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kur aplikohet mbi një trup gjykues, duhet të determinohet nëse ndaras nga sjellja personale e cilitdo gjyqtarë, mund të ketë fakte të mjaftueshme të cilat mund të ngrisin dyshime për paanshmërinë e gjykatës. Në këtë aspekt edhe dukja/perceptimi mund të ketë rëndësi, sepse *“drejtësia jo vetëm duhet të zbatohet, por ajo duhet të shihet që po të zbatohet”* (në këtë kontekst shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së De Cubber kundër Belgjikës, cituar më lart, paragrafi 26). Çështja esenciale është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të reflektojnë në publik (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së Castillo Algar kundër Spanjës, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, paragrafi 45; San Leonard Band Club kundër Maltës, cituar më lart, paragrafi 60; dhe Golubović kundër Kroacisë, cituar më lart, paragrafi 49). Prandaj, cilido gjyqtar për të cilin mund të ketë arsye legjitime për të dyshuar në mungesë paanshmërie, duhet të tërhiqet nga vendimmarrja (shih rastin e GJEDNJ-së Micallef kundër Maltës, cituar më lart, paragrafi 98, si dhe rastet e bashkuara të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues Muhamet Idrizi, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 53).
75. Tutje, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përcakton se situatat në kuadër të të cilave mund të ngritën çështje lidhur me mungesën e paanshmërisë mund të jenë të (i) natyrës funksionale dhe (ii) personale. E para ndërlidhet me ushtrimin e funksioneve të ndryshme brenda një procesi gjyqësor nga i njëjti person ose me lidhje të natyrës hierarkike apo të ndonjë natyre tjetër në mes gjyqtarit dhe akterëve tjerë në procesin e caktuar gjyqësor. Përkitazi me këto të fundit, niveli dhe natyra e kësaj lidhjeje duhet të ekzaminohet. Këto situata të natyrës funksionale mund të përfshijnë shembuj të rasteve kur në të njëjtin rast janë ushtruar funksione (i) këshillëdhënëse dhe gjyqësore (për këtë kontekst, shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së Procola kundër Luxembourgut, Aktgjykim i 8 shtatorit 1995, paragrafi 45; Kleyn dhe të Tjerët kundër Holandës, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafi 200; dhe Sacilor Lormines kundër Francës, Aktgjykim i 9 nëntorit 2006, paragrafi 74); (ii) gjyqësore dhe jashtëgjyqësore (për këtë kontekst, shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së McGonnell v. the United Kingdom, Aktgjykim i 8 shkurtit 2000, paragrafët 52-57); dhe (iii) të ndryshme gjyqësore.
76. Në këtë kontekst, GJEDNJ thekson se vlerësimi nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të procesit gjyqësor mund të ketë rezultuar në shkelje të kërkesave që ndërlidhen me paanësinë e gjykatës, duhet të vlerësohet nga rasti në rast dhe varet nga rrethanat e secilit rast. Asnjë çështje e mungesës së paanësisë gjyqësore nuk lind kur një gjyqtar ka nxjerrë tashmë vendime formale dhe procedurale në faza të tjera të procedurës (shih rastin George-Laviniu Ghiurău kundër Rumanisë, Aktgjykim i 16

qershorit 2020, paragrafi 67). Megjithatë, problemet me paanshmërinë mund të shfaqen nëse, në faza të tjera të procedurës, një gjyqtar ka shprehur tashmë një mendim për fajësinë e të akuzuarit (*Gómez de Liaño y Botella kundër Spanjës*, Aktgjykim i 22 korrikut 2008, paragrafët 67-72). Në këtë aspekt, fakti që i njëjti gjyqtar ka ushtruar dy herë të njëjtin funksion në të njëjtin grup procedurash penale është i pamjaftueshëm për të treguar mungesë objektive të paanësisë (shih rastin, *Teslya kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 8 tetorit 2020).

77. Gjithashtu, GJEDNJ thekson se nëse një detyrim i një gjykate më të lartë që anulon një vendim gjyqësor për t'ia kthyer lëndën gjyqtarëve të ndryshëm parashihet sipas ligjit të brendshëm përkatës, lind pyetja nëse një gjykatë është krijuar me ligj (shih rastin *Lavents kundër Letonisë*, 2002, Aktgjykim i 28 nëntorit 2008, paragrafi 115). Ndërsa e dyta, përkatësisht, ato të natyrës personale, kryesisht ndërlidhen me mënyrën e sjelljes të një gjyqtari përkitazi me një rast ose ekzistencën e lidhjeve me njërën nga palët apo përfaqësuesit të tij/saj në një rast (shih për më tepër në këtë kontekst, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 gushtit 2022, për nenin 6 të KEDNJ-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë (aspekti penal), Pjesa IV. Garancionet e Përgjithshme: Kriteret Procedurale, C. Pavarësia dhe Paanësia, 2. Gjykata e Paanshme, a. Kriteret për vlerësimin e paanësisë (shih në këtë kontekst rastet e bashkuara të Gjykatës [KI187/18 dhe KI11/19](#), parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 54; si dhe [KI24/17](#), cituar me lart, paragrafi 50)

b) *Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*

78. Në aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Pml. nr. 270/22] i Gjykatës Supreme i 13 korrikut 2022, *“jo vetëm që nuk i eviton aspak shkeljet duke vazhduar me të njëjtin avaz të shkeljeve kushtetuese e cila merrë po të njëjtin vendim me të njëjtin kolegji shqyrtues, dhe e shpërfill në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sikur ai të mos ekzistoj fare, as kolegjin nuk e ndryshon, edhe pse kjo e fundit e kishte obliguar Gjykatën Supreme, që kjo çështje të rivendoset nga një kolegji i ri shqyrtues”*.
79. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon mungesë të paanshmërisë se Gjykatës Supreme në rigjykimin e rastit të tij që kishte rezultuar në nxjerrjen e Aktgjykimit [Pml. nr. 270/22] të 13 korrikut 2022 sepse Gjykata Supreme nuk ka vendosur/gjykuar në pajtim me gjetjet e Gjykatës sipas Aktgjykimit KI196/21 të 26 majit 2022, lidhur me paanshmërinë e gjykatës meqë Gjykata Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit të dytë, respektivisht Aktgjykimit [Pml. nr. 270/22] të kontestuar *“...nuk ndryshon as kolegjin shqyrtues edhe asnjë pike të aktgjykimit të mëparshëm, duke i ripërsëritur të njëjtat shkelje si me pare, duke mos ia var veshin Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, edhe pse kjo gjykatë kishte konstatuar shkelje nga Gjykata Supreme”*.
80. Në thelb, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se përbërja e Kolegjit të Gjykatës Supreme në rigjykimin e rastit të tij që kishte rezultuar në nxjerrjen e Aktgjykimit të dytë të Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimit të kontestuar [Pml. nr. 270/22] të 13 korrikut 2022, ka mbetur e njëjtë me përbërjen e kolegjit shqyrtues në gjykimin e rastit të tij nga Gjykata Supreme që kishte rezultuar në nxjerrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021, të shfuqizuar nga Gjykata përmes Aktgjykimit KI196/21.
81. Gjykata vëren se në kontekst të përbërjes së kolegjit shqyrtues të Gjykatës Supreme që kishin rezultuar në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar, parashtruesi sipas pretendimeve në kërkesën e dorëzuar pretendon pikërisht ushtrimin e funksioneve të



ndryshme të një gjyqtareje brenda të njëjtit proces gjyqësor, përkatësisht faktin që gjyqtarja M. M. kishte marrë pjesë 3 (tre) herë në gjykimin e këtij rasti penal, dhe atë dy herë si kryesuese e Kolegjit në Gjykatën e Apelit në nxjerrjen e vendimeve [PAKR. nr. 541/2017] të 26 dhjetorit 2017 dhe [PAKR. nr. 443/2018] të 9 tetorit 2018, dhe si anëtare e Kolegjit në Gjykatën Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021, dhe se fundmi, sipas pretendimit të parashtruesit, përsëri edhe si anëtare e Kolegjit në Gjykatën Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 270/2022] të 13 korrikut 2022, veprime të cilat sipas parashtruesit të kërkesës, serish kanë rezultuar në shkelje të së drejtës së tij për “*gjykim të drejtë dhe të paanshëm*”.

82. Gjithashtu, Gjykata dëshiron të sqarojë se në substance parashtruesi i kërkesës pretendon mungesë të paanshmërisë në rigjykimin e rastit të tij, pasi gjyqtarët V.D., dhe A.M., të cilët ishin pjesë e Kolegjit të ri të Gjykatës Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar, ishin të njëjtit gjyqtarë që morën pjesë në Kolegjin e Gjykatës Supreme që nxorën Aktgjykimin e parë, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 310/21] e 14 shtatorit 2021.
83. Së pari, Gjykata rikujton se në rastin e saj KI196/21, ajo konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së për shkak se Aktgjykimi [PML. nr. 310/2021] i 14 shtatorit 2021, ishte nxjerrë nga përbërja e një Kolegji, në të cilin në kundërshtim me dispozitat përkatëse të procedurës penale, dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, gjyqtarja M. M. kishte marrë pjesë 3 (tre) herë në vendimmarrje të këtij rasti penal dhe atë 2 (dy) herë në nivele të ndryshme gjyqësore. Ajo fillimisht në cilësinë e kryesueses së Kolegjit të Gjykatës së Apelit, ishte pjesë e vendimmarrjes në Aktvendimin [PKRK. nr. 541/2017] të 26 dhjetorit 2017 dhe Aktvendimin [PKRK. nr. 443/2018] të 9 tetorit 2018, dhe në cilësinë e anëtares së Kolegjit shqyrtues mori pjesë në marrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 310/21] të Gjykatës Supreme, të 14 shtatorit 2021, të kontestuar nga parashtruesi në rastin KI196/21.
84. Në vazhdim, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të kontestuar për të vlerësuar nëse Gjykata Supreme ka eliminuar shkaqet që çuan në shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson nëse përbërja e Kolegjit të Gjykatës Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar të [PML. nr. 270/2022] të 13 korrikut 2022 ishte e njëjtë me përbërjen e Kolegjit të Gjykatës Supreme që kishte nxjerrë Aktgjykimin [PML. nr. 310/21] e 14 shtatorit 2021.
85. Gjykata fillimisht vëren se Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të kontestuar, duke trajtuar për herë të dytë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, kishte theksuar se “*Gjykata Supreme e Kosovës, pasi eliminoi shkeljen e theksuar në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës se Kosovës serish rishqyrtoi pretendimet e paraqitura në kërkesa...*”, të cilat rezultuan të pabazuara.
86. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme “*nuk ndryshon as kolegjin shqyrtues edhe asnjë pike të aktgjykimit të mëparshëm, duke i ripërsëritur të njëjtat shkelje si me pare, duke mos ia var veshin Gjykatës Kushtetuese të Republikës se Kosovës, edhe pse kjo gjykate kishte konstatuar shkelje nga Gjykata Supreme*”.
87. Gjykata fillimisht vëren se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se gjyqtarja M.M., e cila në cilësinë e anëtares së Kolegjit shqyrtues kishte marr pjesë në gjykimin e rastit të tij, respektivisht në nxjerrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 310/21] të Gjykatës Supreme të 14 shtatorit 2021, tashmë nuk ishte pjesë përbërëse e Kolegjit të Gjykatës Supreme në rigjykimin e rastit të parashtruesit, përkatësisht në nxjerrjen e Aktgjykimit të dytë [PML. nr. 270/2022] të Gjykatës Supreme të 13 korrikut 2022, të kontestuar para Gjykatës nga parashtruesi.

88. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se Kolegji i Gjykatës Supreme që kishte nxjerrë Aktgjykimin [PML. nr. 310/21] e Gjykatës Supreme të 14 shtatorit 2021 ishte i përbërë nga V.D., A.M. si dhe nga gjyqtarja M.M. Ndërsa, pas rikthimit të rastit në rigjykim në Gjykatën Supreme, Kolegji i Gjykatës Supreme që kishte nxjerrë Aktgjykimin e dytë, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 270/2022] e Gjykatës Supreme të 13 korrikut 2022, ishte i përbërë nga V.D., A.M. dhe N.L. Gjykata vëren se gjyqtarja M.M. nuk ishte pjesë e Kolegjit të Gjykatës Supreme herën e dytë në nxjerrjen e Aktgjykimet të kontestuar. Rrjedhimisht, përbërja e Kolegjit të Gjykatës Supreme në Aktgjykimin e kontestuar nuk rezulton të jetë i njëjtë/identik me atë paraparak.
89. Megjithatë, Gjykata në anën tjetër vëren se gjyqtarët V.D., dhe A.M., që ishin pjesë e Kolegjit të Gjykatës Supreme që kishin nxjerrë Aktgjykimin [PML. nr. 310/21] e Gjykatës Supreme, ishin përsëri pjesë e Kolegjit të Gjykatës Supreme që kishin nxjerrë Aktgjykimin e dytë, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 270/2022] e Gjykatës Supreme të 13 korrikut 2022, të kontestuar para Gjykatës nga parashtuesi i kërkesës.
90. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës në thelb pretendon se Kolegji i ri i Gjykatës Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimi të kontestuar do duhej të ishte tërësisht i ndryshëm nga Kolegji paraparak i Gjykatës Supreme që kishte nxjerrë Aktgjykimin [PML. nr. 310/21] e 14 shtatorit 2021, në mënyrë që të plotësohen kërkesat për paanshmëri në rigjykimin e rastit të tij.
91. Në këtë aspekt, GJEDNJ ka mbajtur se jodetyrimisht përbërja e njëjtë e trupave gjyqese në shqyrtimin e një çështje të njëjtë në faza të ndryshme të procesit, rezulton në shkelje të drejtës në gjykim të paanshëm dhe se shkelje të tilla të mundshme varen nga rrethanat specifike të një rasti. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se si rregull i përgjithshëm, në rastet kur një gjykatë me e lartë e cila kthen një çështje në rishqyrtim, është e detyruar që çështjen ta kthejë të një kolegj me një tjetër përbërje (shih rastin e Gjykatës [KI24/17](#), cituar me lart, paragrafi 56; si dhe rastin e GJEDNJ-se [Ringeisen kundër Austrisë, kërkesa nr. 4455/10](#), Aktgjykim i 17 korrikut 1971, paragrafi 97).
92. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se detyrimi për të qenë i paanshëm nuk mund të interpretohet në mënyrë që t'ia imponojë një detyrim një gjykatë më të lartë e cila anulon një vendim administrativ ose gjyqësor për ta kthyer lëndën në një autoritet tjetër juridiksioni ose në një degë të përbërë ndryshe të atij autoriteti (shih rastin e GJEDNJ-së [Marguš kundër Kroacisë, kërkesa nr. 4455/10](#), Aktgjykim i 27 majit 2014, paragrafi 85; si dhe rastin [Ringeisen kundër Austrisë, kërkesa nr. 2614/65](#), Aktgjykim i 16 korrikut 1971, paragrafi 97). Gjykata thekson se fakti që një gjyqtar gjyqes ka marrë vendime të mëparshme në lidhje me të njëjtën rast nuk mund të konsiderohet në vetvete si justifikim i frikës për paanshmërinë e tij/saj (shih rastin e GJEDNJ-së, [Thomann kundër Zvicrës, kërkesa nr. 17602/91](#), Aktgjykim i 25 janarit dhe 21 majit 1996).
93. Gjykata ve në dukej se, përmes Aktgjykimit KI196/21, konkludoi se Aktgjykimi i nxjerrë për herë të parë [PML. nr. 310/2021] i Gjykatës Supreme i 14 shtatorit 2021, ishte në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo pasi gjyqtarja M.M. mori pjesë në vendimarrjen e çështjes penale të parashtuesit në instanca të ndryshme gjyqësore, përkatësisht si kryesuese e kolegjeve në Gjykatën e Apelit për çështjen penale të parashtuesit të kërkesës, dhe si anëtare e Kolegjit në Gjykatën Supreme për kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Në këto rrethana, dyshimet për mungesën e paanshësisë së gjykatës ishin të justifikuar.
94. Në rastin konkret, gjykata nuk vëren se gjyqtarët V.D., dhe A.M. kishin marrë pjesë në procedura të mëhershme në instanca të niveleve të ndryshme gjyqësore lidhur me rastin e parashtuesit. Kjo dallon prej rastit të lartpërmendur, ku gjyqtarja që mori pjesë në

- vendimmarrjen në fazat e mëhershme të çështjes penale ishte gjithashtu pjesë e vendimmarrjes në Gjykatën Supreme.
95. Gjykata nënvizon se nuk ka asnjë bazë legjitime për të dyshuar në paanshmëri duke marrë parasysh se i njëjti gjyqtar ka marrë njëherë pjesë në procesin e vendimmarrjes në një instance gjyqësore dhe më pastaj në procedurën e re, kur vendimi i mëparshëm anulohet dhe çështja i kthehet të njëjtit gjyqtar për rigjykim. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se nuk mund të përcaktohet si një rregull i përgjithshëm që rezulton nga detyrimi për të qenë i paanshëm që një gjykatë e lartë që anulon një vendim gjyqësor është e detyruar t'ia kthejë çështjen një paneli të përbërë ndryshe (shih rastin e Gjykatës [KI24/17](#), cituar me lart, paragrafi 56 dhe rastin e GJEDNJ-së [Ringeisen kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 97). Megjithatë, Gjykata ve theksin mbi atë se ndonëse detyrimi për të qenë i paanshëm nuk implikon që një gjykatë e lartë, pas anulimit të një vendimi gjyqësor, duhet të transferojë çështjen në një panel me përbërje plotësisht të ndryshme, përveç në rastet kur elementet e paanshmërisë janë të pranishme dhe të arsyetuara.
96. Gjykata në anën tjetër dëshiron të sqarojë se nëse një detyrim i një gjykate më të lartë për anulimin e një vendimi gjyqësor dhe rikthimin e çështjes për shqyrtim të ri para gjyqtarëve të tjerë parashikohet nga ligji i brendshëm përkatës, atëherë paraqitet çështja se nëse krijimi i një gjykate të re është i rregulluar ligjërisht dhe në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshëm (shih rastin e GJEDNJ-së [Lavents kundër Letonisë, kërkesa nr. 58442/00](#), Aktgjykim i 28 nëntorit 2002, paragrafi 115).
97. Në këtë aspekt, Gjykata do t'i referohet pjesës relevante të paragrafit 3 të nenit 39 të Kodit të Procedurës Penale i cili përcakton se *“Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i Kolegjit të Apelit apo Kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues”*.
98. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka vepruar me kujdes në mënyrë që të evitojë çdo dyshim për paanshmëri, duke larguar gjyqtaren M.M. nga procesi i rigjyimit të rastit të parashtruesit në herën e dytë. Duke u bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë që dy gjyqtarët, respektivisht V.D., A.M. ishin dy herë anëtarë të trupit gjykues në nivel të Gjykatës Supreme, njëherë në gjykimin dhe me pas në rigjykimin e rastit të parashtruesit të kërkesës, nuk mjafton për të ngritur dyshime të justifikuar objektivist për paanshmërinë e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së [Marguš kundër Kroacisë, kërkesa nr. 4455/10](#), cituar me lart, paragrafi 85; si dhe [Inseher kundër Gjermanisë, kërkesa nr. 10211/12 dhe 27505/14](#), paragrafi 288, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2018). Në këtë kontekst, detyrimi për të qenë i paanshëm në asnjë mënyrë nuk sugjeron që një gjykatë e lartë, në rastin e anulimit të një vendimi gjyqësor, është e detyruar ta referojë çështjen në një panel me përbërje plotësisht të ndryshme, veç pse vendimi i mëparshëm ishte i papranueshëm apo në disfavor për parashtruesin e kërkesës.
99. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë që një gjyqtar apo trup gjykues ka marrë tashmë vendime paraprake të pafavorshme për parashtruesin nuk mund të konsiderohet në vetvete si shqetësim i justifikueshëm për paanshmërinë e tij. Ajo që ka rëndësi është shtrirja dhe natyra e masave të marra nga gjyqtari para gjykimin. Po kështu, fakti që gjyqtari apo trupi gjykues ka njohuri të hollësishme për dosjen e rastit nuk sjell ndonjë paragjykim nga ana e tij që do të parandalonte që ai të konsiderohej i paanshëm kur merret vendimi për meritat. As një analizë paraprake e informacionit në dispozicion

nuk do të thotë se analiza përfundimtare e rastit është e paragjykuar (shih rastin e GJEDNJ-së [Morel kundër Francës](#), Aktgjykim i 6 qershorit 2000, paragrafi 45 dhe referencat aty).

100. Nën dritën e kësaj, Gjykata thekson se mungesa e paanshmërisë gjyqësore nuk lind kur një instance gjyqësore njëherë ka marrë një vendim të pafavorshëm për mbrojtjen me një rezultat të njëjtë për parashtruesin e kërkesës sikur me vendimin paraprak i cili me pas ishte shfuqizuar, siç është situata në rastin e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, problemet me paanshmërinë mund të shfaqen nëse, në fazat e tjera të procedurës, një gjyqtar ka shprehur tashmë një opinion mbi fajësinë e të akuzuarit (shih rastin e GJEDNJ-së [Gómez de Liaño y Botella kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 22 korrikut 2008, paragrafët 67-72).
101. Në kontekstin specifik të kësaj çështje, Gjykata vëren se Aktgjykimi i kontestuar ishte vërtet i pafavorshëm për mbrojtjen. Por, për të kapërcyer supozimin e paanshmërisë, Gjykata duhet të ketë një dëshmi më të fortë të paragjyqësive, me shumë se një vendim që në thelb ishte në disfavor të parashtruesit. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për përbërjen e njëjtë të kolegjit në dy vendimet kontestuese gjatë gjykimit të rastit, nuk e bindin Gjykatën se kishte njëanshmëri. Pa analizuar në këtë pikë, nëse vendimet kontestuese ishin të justifikuar, Gjykata vëren se nuk kishte asgjë në to për të zbuluar ndonjë predispozitë kundër parashtruesit të kërkesës (shih rastin e GJEDNJ-së [Miminoshvili kundër Ruisisë](#), Aktgjykim i 28 qershorit 2011, paragrafi 114).
102. Në dritën e sa më sipër, Gjykata thekson se pretendimet që mund të ketë pasur parashtruesi i kërkesës për paanshmërinë e Kolegjit të Gjykatës Supreme nuk konsiderohen të jenë të justifikuar në mënyrë objektive sepse: (i) nuk ka asgjë në shkresat e lëndës që sugjerojnë se ndonjë gjyqtar apo trupi gjyqësor ka shprehur qëndrim armiqësor apo vullnet të keq ndaj parashtruesit të kërkesës; dhe se (iii) përbërja e Kolegjit nuk ka shprehur paraprakisht opinion lidhur me fajësinë e parashtruesit të kërkesës çka do ta komprometonte procesin penal kundër tyre; si dhe (iii) përbërja e Kolegjit të Gjykatës Supreme në rigjykimin e rastit nuk ishte e njëjtë/identike me atë të rastit paraprak; si dhe (iv) Gjykata Supreme në procedurën e rivendosjes ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të evituar çdo dyshim për paanshmëri, duke vendosur largimin e gjyqtarës M.M. nga procesi i rigjykimit të rastit të parashtruesit të kërkesës.
103. Gjykata, pas analizës së kujdesshme të rrethanave të këtij rasti, arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte të konstatueshme që mund të shkaktonin dyshime të justifikuar në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarëve V.D. dhe A.M. Parashtruesi, në këtë kontekst, nuk paraqet asnjë arsye legjitime për të shprehur frikësim ose pasiguri lidhur me objektivitetin dhe pavarësinë e Gjykatës Supreme. Prandaj, Gjykata konfirmon se çështja në fjalë nuk përfshihet në asnjë shkelje të kërkesave për paanshmëri gjyqësore.
104. Gjykata në fund thekson se në një shoqëri demokratike sipas KEDNJ-së, e drejta për një administrim të drejtë të drejtësisë zë një vend aq të rëndësishëm sa që një interpretim i përpiktë/restruktiv i garancive të nenit 6 nuk do t'i përgjigjej qëllimit dhe objektivitetit të kësaj dispozite (shih mutatis mutandis rastet e GJEDNJ-së [Ryakib Biryukov kundër Ruisisë, kërkesa nr. 14810/02](#), Aktgjykim i 17 janarit 2018, paragrafi 37; [Delcourt kundër Belgjikës, kërkesa nr. 2689/65](#), Aktgjykim i 17 janarit 1970, paragrafi 25; [Wemhoff kundër Gjermanisë, kërkesa nr. 2122/64](#), Aktgjykim i 27 qershorit 1968, paragrafi 8).
105. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës në lidhje me Aktgjykimin e kontestuar specifikisht pretendon "*Kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe sigurisë, mos përcaktueshmërisë së veprës penale neni 2 paragrafi 2 dhe neni 3 i KPRK-së në raport me*

*parashtruesin e kërkesës ku me aktgjykime të kundërligjshëm të nxjerrë nga gjykatat e rregullta duke mos e përfillur procedurën e përcaktuar me ligj përkatësisht nenin 12 par 1 lidhur me nenin 307 par 2 të Kodit Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr 38/ 28 dhjetor 2012, Prishtinë (tutje i referohemi me KPP)”.*

106. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës rrjedhimisht pohon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar ka dështuar të jap arsyetim dhe njëkohësisht ka shprehur arbitraritet në vendimmarrje.
107. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës kishte theksuar se *“aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyetim të hollësishëm dhe në mënyrë të plotë janë theksuar provat vendimtare që kanë vërtetuar fajësinë e të dënuarve. Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës se shkallës se parë është konstatuar se gjendja faktike është vërtetuar bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe mes tjerash edhe përmes dëshmive të dëshmitareve L.Sh., dhe A.B., kurse dëshmitë e tyre dhe besueshmëria këtyre dëshmive janë arsyetuar në mënyrë të qartë në aktgjykimin e gjykatës se shkallës se parë”.*
108. Gjithashtu, Gjykata Supreme duke ju referuar gjendjes faktike kishte theksuar se *“aktgjykimi i gjykatës se shkallës se parë nuk bazohet vetëm mbi dëshmitë e dëshmitareve, por edhe provave materiale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor”.*
109. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar ka dhënë arsye bindëse dhe të mjaftueshme duke shtjelluar në detaje bazën ligjore që kishte bazuar vendimin e saj, duke iu referuar dispozitave përkatëse ligjore që ajo i kishte konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret.
110. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës edhe më tutje mund të mos jetë i kënaqur me arsyetimin dhe bazën ligjore të zbatuar nga Gjykata Supreme. Megjithatë, në praktikën e saj gjyqësore në mënyrë konsistente, Gjykata ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit bien brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, mes tjerash, Gjykata Kushtetuese rasti nr. [KI33/16](#), parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91).
111. Për më tepër, Gjykata gjen se vendimmarrja e Gjykatës Supreme, në rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret, është e arsyetuar dhe përmban fakte të vërtetuara, dispozita ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre.
112. Për më tepër, Gjykata konstaton se të gjitha vërejtjet e dhëna nga Gjykata në Aktgjykimin e saj të 26 majit 2021 (rasti KI196/21), për sa i përket paanshmërisë së gjykatës lidhur me përbërjen e Kolegjit në Gjykatën Supreme tashmë janë konsumuar sepse në Aktgjykimin e kontestuar janë eliminuar shkaqet të cilat kanë shkaktuar mungesë të paanshmërisë së gjykimin të këtij rasti penal e që kishin të bënin me pjesëmarrjen e gjyqtarës M.M., e cila në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar nuk ishte më pjesë e Kolegjit të Gjykatës Supreme.
113. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse argumentet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk

tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës.

114. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

### ***Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme***

115. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme për të pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve ndaj tij, të shqiptuar me Aktgjykimin [PAKR. nr. 179/221] të Gjykatës së Apelit dhe të vërtetuar me Aktgjykimin e kontestuar [PML. nr. 270/2022] të Gjykatës Supreme të 13 korrikut 2022, derisa Gjykata të marrë vendim për kërkesën.
116. Megjithatë, ashtu siç është specifikuar si më lart, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme si qartazi e pabazuar.
117. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe pikën (a) dhe pikën (b) të paragrafit (2) të rregullit 45 (Vendimmarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa të deklarohet e papranueshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI107/19, me parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafët 88-90; KI159/18, me parashtrues *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 majit 2019, paragrafët 89-91; KI19/19 e KI20/19, parashtrues *Muhamed Thaqi dhe Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 gushtit 2019, paragrafët 53-55; dhe KI211/19, cituar më lart, paragrafi 83).

### **Përfundim**

118. Gjykata thekson se pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, çështje këto të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në rrethanat e rastit konkret, janë çështje esenciale kushtetuese.
119. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi [Pml. nr. 270/2022] i 13 korrikut 2022 i Gjykatës Supreme është nxjerre nga një gjykatë e paanshme në kuptimin e testit subjektiv dhe objektiv të përcaktuar nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rrjedhimisht është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse përkundër faktit që gjyqtarët V. D. dhe A.M. ishin anëtarë të Kolegjit të Gjykatës Supreme të cilët nxorën Aktgjykimin e kontestuar në procedurën e rigjyimit, rezultuan të ishin edhe anëtarë të Kolegjit të Gjykatës Supreme herën e pare që nxorën Aktgjykimin [Pml. nr. 310/2021] në rastin e parashtruesit të kërkesës, asnjë prove apo argument tjetër i parashtruesit të kërkesës nuk e përmbys prezumimin e paansisë së gjyqtarëve përkatës; si dhe (ii) dyshimet legjitime për mungesën e paansisë së gjykatës nuk janë objektivist të justifikueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 34 (2), 45 (2) (b) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 gusht 2023, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

**Gjyqtarja raportuese**

  
Remzije Istrefi-Peci



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka Nimani